

## RELACION

Mbi

### RAPORTET E MONITORIMI TË VITIT 2018

Me Ligjin Nr.109 datë 30.11.2017 “Për Buxhetin e vitit 2018”, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, i është miratuar buxheti fillestar për vitin 2018 prej 47.542.630.000 lekë, nga të cilat 4.777.830.000 lekë për shpenzime korrente dhe 42.764.800.000 lekë për shpenzime kapitale.

Me Aktin Normativ nr.1 datë 26.07.2018 dhe Aktin Normativ nr. 2 datë 19.12.2018 , “Për disa ndryshime në ligjin nr.109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, buxheti ka pësuar ndryshime (shtesa/pakësime) duke arritur në vlerën 47.681.180.000 lekë, nga të cilat 5.697.830.000 lekë për shpenzime korrente dhe 41.983.350.000 lekë për shpenzime kapitale.


Detajimi i buxhetit për vitin 2018 është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 si dhe në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë dhe është realizuar sipas programeve buxhetore ku janë mbajtur parasysh objektivat, qëllimi i synuar, si dhe lidhjet midis politikave sektoriale dhe aktiviteteve nga ku janë përcaktuar dhe buxhetet për çdo program.

Për vitin 2018, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë administroi dhe menaxhoi fondet buxhetore sipas 11 programeve, si më poshtë :

- Planifikim, Menaxhim, Administrim
- Transporti Rrugor
- Transporti Detar
- Transporti Hekurudhor
- Transporti Ajror
- Furnizimi me Uje dhe Kanalizime
- Menaxhimi i Mbetjeve Urbane
- Mbështetje për Energjinë
- Mbështetje për Burimet Natyrore
- Mbështetje për Industrinë
- Planifikimi Urban

Buxheti faktik për vitin 2018 është realizuar 38.6 miliard lekë kundrejt 48.6 miliard lekë ose 79 %.

								ne 000/leke
Emri i Grupit	Ministria e Infrastruktures dhe Energjise					Kodi i Grupit	06	
Programet		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit						
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)-(6)-(5)
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	
Titulli	Emertimi	i vitit paraardhes Viti 2017	Viti 2018	Plan Fillestar Viti 2018	Plan i Rishikuar Viti 2018	Plani i Periudhes/progressiv	i Periudhes/progressiv	Diferenca
01110	Planifikim Menaxhimi	2,244,288	691,987	691,987	953,287	953,287	893,771	59,516
04520	Transporti Rrugor	23,299,271	24,415,501	24,415,501	27,002,239	23,673,404	23,511,097	162,307
04540	Transporti Detar	132,444	291,760	150,260	326,260	383,130	158,685	224,445
04550	Transporti Hekurudhor	436,871	1,273,680	1,273,680	1,053,891	1,053,891	460,722	593,169
04560	Transporti Ajror	12,995	25,110	25,110	20,610	20,610	13,556	7,054
06370	Furnizimi me Uje dhe Kanalizime	11,657,466	10,616,800	10,620,580	9,762,496	9,762,496	8,123,467	1,639,029
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	1,009,707	2,554,902	2,564,272	2,767,272	2,767,272	2,340,494	426,778
04320	Mbeshtetje per Energjine	176,334	6,097,900	6,097,900	8,652,175	8,652,175	1,836,765	6,815,410
04430	Mbeshtetje per Burimet Natyrore	35,780	315,000	551,200	373,691	373,691	359,246	14,445
04440	Mbeshtetje per Industrine	148,055	406,740	406,740	399,912	399,912	376,710	23,202
06180	Planifikimi Urban	220,876	743,400	743,400	604,250	604,250	493,018	111,232
Totali i Shpenzimeve te Ministrise		39,374,087	47,432,780	47,540,630	51,916,083	48,644,118	38,567,531	10,076,587
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit								
Totali		39,374,087	47,432,780	47,540,630	51,916,083	48,644,118	38,567,531	10,076,587



## Monitorimi i shpenzimeve sipas programeve

### 1. PLANIFIKIM MENAXHIM ADMINISTRIMI

Programi “Planifikim, Menaxhim, Administrim”, planifikon/detajon, monitoron dhe menaxhon fondet buxhetore (shpenzime korrente dhe kapitale), të miratuara me ligjin vjetor të buxhetit, për realizimin e qëllimit dhe arritjen e objektivave të politikës së programit, për funksionimin dhe forcimin e kapaciteteve administrative të Aparatit të Ministrisë së Infrastruktës dhe Energjisë, rritjen e standardeve dhe performancës së punës së tyre.

## **SHPENZIMET KORRENTE**

*Paga dhe sigurime*, plani vjetor 2018 prej 308.7 milion lekë është realizuar në vlerën 305.4 milion lekë ose 81%.

*Shpenzime operative*, plani vjetor 2018 prej 359 milion lekë është realizuar në vlerën 314.8 milion lekë ose 88%.

*Transfertat korrente të brendshme*, plani vjetor 2018 prej 12 milion lekë është realizuar në vlerën 12 milion lekë ose 100%.

*Transfertat korrente të huaja*, plani vjetor 2018 prej 27 milion lekë është realizuar në vlerën 24.2 milion lekë ose 90%.

*Transfertat për Buxhetin Familjar dhe Individual*, plani vjetor 2018 prej 97.8 milion lekë është realizuar në vlerën 97.7 milion lekë ose 100%.

## **SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM**

Buxheti i vitit 2018, për investimet me financim të brendshëm, për këtë program është planifikuar në shumën 40.7 milion lekë dhe realizimi financiar për periudhën vjetore, është në shumën 31.5 milion lekë ose 77%.

Sipas projekteve ai paraqitet :

- “Blerje orendi dhe pajisje zyre”, është planifikuar në vlerën 13.5 milion lekë dhe është realizuar në vlerën 13.5 milion lekë, ose 100%.
- “Riparim rrjeti elektrik dhe hidraulik”, është planifikuar në vlerën 35 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 35 mijë lekë, ose 100%.
- “Rikonstruksioni i godinës ish MZHU”, është planifikuar në vlerën 18 milion lekë dhe është realizuar në vlerën 16.2 milion lekë, ose 90%.
- “Instalimi i sistemit të ri me kamera të sigurisë”, është planifikuar në vlerën 800 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 538 mijë lekë, ose 67%.

## **2. TRANSPORTI RRUGOR**

Bazuar në objektivin e përgjithshëm të Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimtimit 2016-2020, që synon: (i) të zhvillojë më tej sistemin kombëtar të transportit; (ii) të përmirësojë ndjeshëm qëndrueshmërinë, ndërlidhjen, ndërveprimin dhe integrimin e tij më gjerë, me sistemin ndërkombëtar dhe evropian të transportit dhe rajonin etj, Programi i Transportit Rrugor mbulon me financim zgjerimin, rritjen e standardeve dhe mirëmbajtjen e rrjetit kombëtar të rrugëve, përfshirë korridoret dhe rrugët për në destinacionet kufitare dhe turistike, me synim krijimin e një transporti të qëndrueshëm, që nënkupton uljen e kostos, rritjen e shpejtësisë së lëvizjes, sigurinë rrugore a atë fizike të mjetit, udhëtarit dhe ngarkesës, si dhe parametra të pranueshëm mjedisorë. Në këtë kuadër, programi, financon gjithashtu, përgatitjen e studimeve, projekteve dhe mbikqyerjen e punimeve.

Performanca e produkteve të programit “Transporti rrugor ” paraqiten si më poshtë:

### **FINANCIMI I BRËNDSHËM**

Shpenzimet kapitale (me financim të brendshëm) të këtij programi, fondet e planifikuara janë 15,401,041,000 lekë dhe realizimi i tyre është 15,280,567,000 lekë ose 99 % .

Me buxhetin e vitit 2018 në ARRSH u mbështetën me fonde buxhetore të gjitha kontratat në vazhdim dhe u lidhën dhe kontrata të reja. Me buxhetin e vitit 2018 u financuan totalisht 26

objekte të zërit Ndërtim dhe Sistemim Rrugësh, 8 objekte të zërit Studim Projektme dhe 2 objekte të zërit Sinjalistikë dhe Siguri Rrugore.

Gjithashtu me buxhetin e vitit 2018 u mbajt parasysh likuidimi i detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme. Me buxhetin e vitit 2018 u likuiduan të gjithë detyrimet e prapambetura të zërit Ndërtim e Sistemim rrugësh, TVSH & Kosto Lokale, Supervizion Punimesh. U likuiduan 78% e detyrimeve të zërit Studim Projektme dhe 68 % e detyrimeve të zërit Vendime Gjyqësore.

Shpenzimet korente të planifikuara në vlerën 1,728,113,000 lekë u realizuan 1,718,903,000 lekë ose 99.5 %. Me buxhetin e vitit 2018 janë mbështetur me financim si kontratat e vjetra të mirëmbajtjes ashtu edhe kontratat e reja të lidhura në vitin 2018. Me rialokimet gjatë vitit 2018, ARRSH ka likuiduar dhe detyrime të prapambetura që u krijuan gjatë vitit buxhetor 2018.

Nga të dhënat e “Raportit të realizimit të produkteve dhe i shpenzimeve faktike të programit sipas produkteve” rezulton se:

Grupi i produktit “Ndërtim Rruge” i shprehur në sasi (km) për 12 mujorin e vitit 2018 është realizuar ndaj planit vjetor përkatësisht 99.8 % (ose 13.16 km) dhe i shpenzimeve faktike për këtë produkt 99.4 % ose 9,045,018,000 lekë.

Produktet e shprehur në terma sasiorë (km) sipas tipeve të ndërtimit të rrugëve (tip A2 me katër korsi, A2’ 2x2 me trotuare dhe ndriçim, B1’ me dy korsi, C2 dhe me dy korsi), janë planifikuar për vitin 2018 konkretisht:

PLANIFIKUAR	FINANCUAR
A2 - 0.41 km	0.41 km ose 100 %
A - 0 km	0 km ose 0 % me standardin e ri
A2’ - 3.81 km	3.78 km ose 99.2 %
B1’ - 6.71 km	6.71 km ose 100 %
C2 - 2.26 km	2.26 km ose 16.6 %
C2’ – 0 km	0 km ose 0 %

Për zërin “Ndërtim rruge” është akorduar fond për kontratat në vazhdim si dhe për kontratat e reja.

Grupi i produktit “Rikonstruksion Rruge” i shprehur në sasi (km) për vitin 2018 është realizuar rreth 100 % ndaj planit vjetor të vitit 2018 (ose 13.16 km), dhe i shpenzimeve faktike për këtë produkt 100 % ose 2,243,677,000 lekë.

Shpenzimet e këtij grupi janë planifikuar për financimin e rrugëve Tip C2 me dy korsi.

Produktet e shprehur në terma sasiorë (km) sipas tipeve për rikonstruksionin e rrugëve (tip C2 & B’ me dy korsi dhe A2’ 2x2 me trotuare dhe ndriçim), janë planifikuar për vitin 2018 :

PLANIFIKUAR	FINANCUAR
C2 - 26.45 km	26.45 km ose 100 %

Për zërin “Rikonstruksion rruge” është akorduar fond për të gjithë kontratat në vazhdim.

#### **Ndërtim rruge tip A2 me katër korsi (2x2):**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 1,066,519,000 lekë (11.7 % ndaj planit total vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge”) dhe në sasi 0.41 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit janë në vlerën 1,063,697,000 leke (11.69 % ndaj planit vjetor “Grupi i produktit “Ndërtim Rruge”) ose (99.7 % ndaj planifikimit për këtë

tip rrugë) dhe në sasi 0.41 km ose 100 % të planit për këtë tip rrugë. Përfshihen në këtë grup rrugë me katër korsi dhe gjerësi 20-25 m, me disa objekte të rëndësishme si:

- Ndërtim By pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë nga Loti 8 deri në Lotin 11;
- Ndërtim rruga Kukës-Morinë Loti2 (dy viadukte) dublimi;
- Ndërtim rruga Kukës-Morinë Loti1, (V. Arti të mëdha) dublimi”;
- Ndërtim rruga Kukës-Morinë Loti2 (dy viadukte) dublimi (shtese punimesh);
- Plotësim, rakordim, masa mbrojtëse dhe siguri rrugore ne viaduktet e aksit Kukës-Morinë;
- Vendosja e mbikalimeve ne aksin rrugor Thumane - Milot dhe Kukës – Morinë.

### **Ndërtim rrugë tip A me katër korsi (2x2) sipas Standardeve të Reja:**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 569,000 lekë (0.06 % ndaj planit total vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rrugë”) dhe në sasi 0 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit janë në vlerën 0 leke (0 % ndaj planit vjetor “Grupi i produktit “Ndërtim Rrugë”). Përfshihen në këtë grup rrugë:

- Rehabilitim i segmentit rrugore mbikalimi pallati me shigjeta rreth rrotullimi Shqiponja Loti 1, Loti 2, Loti 3.

### **Ndërtim rrugë tip A2’ 2x2 me trotuare dhe ndriçim:**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 4,304,386,000 lekë (46.7 % ndaj planit të përgjithshëm vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rrugë”) dhe në sasi 3.81 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 4,253,599,000 lekë (46.6% ndaj planit vjetor Grupi i produktit “Ndërtim Rrugë”) ose 98.8 % ndaj planifikimit për këtë tip rrugë) dhe në sasi janë realizuar 3.78 km ose 99.2 % të planit për këtë tip rrugë.

Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rrugë me katër korsi dhe gjerësi që varion nga 24-25 m, me disa objekte të rëndësishëm që janë në proces si:

Ndërtim nyja lidhëse e rrugës Milot-Lezhë, Rrëshen, Thumanë;

Përfundim i Punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore nyja e Milotit;

Ndërtim rruga Unaza e re Tiranës (segmenti Komuna e Parisit - rruga e re Tiranë - Elbasan);

Rikonstruksion segmenti rrugor Kodër-Kamëz Tapizë + shtesë punimesh ;

Plotësimi dhe përfundimi i objektit - Ndërtim rruga Unaza e Re e Tiranës, Komuna e Parisit - Shkolla Teknologjike, pjesa e mbetur km 0.00-km0.640 + shtesë punimesh;

Ndërtim i unazës së Jashtme Tiranë pjesa verilindore (seg Kth Saukut-Bregu i lumit) Loti 1+ shtesë punimesh, Loti 2, Loti ;

Rikualifikim i akseve rrugore Unaza Lindore Loti 2 , Loti 3;

Ndërtim rruga By Pass Perëndimor Shkodër, Loti 1 + shtesë punimesh.

### **Ndërtim rrugë tip B1’ me dy korsi:**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 1,757,513,000 lekë (19.3 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rrugë”) dhe në sasi 6.71 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 1,757,413,000 lekë (100 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rrugë”) ose (19.3 % ndaj planifikimit për këtë tip rrugë) dhe në sasi janë realizuar 6.71 km ose 100 % të planit të këtij tipi rrugë.

Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rrugë me dy korsi dhe gjerësi që varion nga 10-17 km, duke përmendur disa objekte të rëndësishme në të cilat punohet me ritme të parashikuara :

-Ndërtim Rrugë Kardhiq-Delvinë Loti 1+ shtesë punimesh;

-Ndërtim Rrugë Kardhiq-Delvinë Loti 4, Loti 5, Loti 6;

-Ndërtim rruga Milot - F. Krujë (dublimi i superstradës) Loti 3.

### **Ndërtim rruge tip C2 dhe C2' me dy korsi:**

Për tipin e rrugës C2 janë planifikuar fonde në vlerën 1,971,316,000 lekë ose 22 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge”) dhe në sasi 2.26 km.

Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës C2 është 1,970,309,000 lekë (21.6 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge”) ose (99.9 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge) dhe në sasi janë realizuar 2.26 km ose 100 % të planit të këtij tipi rruge.

Janë përfshirë kryesisht tip rruge C2 me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 7.5-10 m.

Po punohet normalisht në objektet që janë në proces:

- Ndërtim By Pass Tepelenë Loti 1;
- Ndërtim i aksit Skrapar-Përmet Loti 1+ shtesë punimesh;
- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore -vazhdimi Loti 1;
- Rikonstruksioni aksit rrugor ura e Gajdarit hyrja Sarandë;
- Ndërtim mbrojtja nga lumi km 9+500 rruga e re Milot-Skuraj;
- Përmirësim i sigurisë rrugore në aksin Kashar – Rinas.

### **Rikonstruksion rruge tip C2 me dy korsi:**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 2,243,677,000 lekë (100 % ndaj planit vjetor ( Grupi i produktit “Rikonstruksion Rruge) dhe në sasi 26.45 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 2,243,677,000 lekë (100 % ndaj planit vjetor ( Grupi i produktit “Rikonstruksion Rruge) ose (100 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge) dhe në sasi janë realizuar 26.45 km ose 100 % kundrejt planit të këtij tipi rruge.

Përfshihen kryesisht (Sistemim Asfaltim) rruge me gjërësi deri 8.5 metra tip C2.

Janë në proces ndërtimi disa objekte të rëndësishme si:

- Riveshje dhe Sistemim Asfaltim Elbasan- Banjë Loti 1 (shtesë punimesh), Loti 3 + (shtesë punimesh);
- Sistemim asfaltim rruga Tri Urat-Leskovic shtesë punimesh;
- Përmirësimi i shtresave rrugore dhe i sinjalistikës segmenti rrugor Fushë - Krujë – Thumanë shtesë punimesh;
- Sistemim asfaltim masa inxhinierike ne Km.21 + 050, në rrugën Qafë Thanë Lin-Pogradec + shtesë punimesh;
- Pjesa e mbetur e punimeve në segmentin Lin-Pogradec, km 4 deri 21;
- Riveshje dhe Sistemim Asfaltim rruga Përmet – Këlcyrë Loti 3+ shtesë punimesh;
- Plotësimi i punimeve të mbetura dhe lidhja me rrugën ekzistuese të objektit Sistemim Asfaltim Rruga Korçë - Ersekë, Loti 1;
- Sistemim asfaltim Rruga Librazhd-Qafë Stude Loti 3 (shtesë punimesh);
- Sistemim Asfaltim Rrugët lidhëse me bregdetin (Llogara-Sarandë) Loti 1 + shtesë punimesh.

### **Sinjalistikë dhe Siguri Rrugore.**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 263,301,717 lekë (100 % ndaj planit vjetor ( Grupi i produktit Sinjalistikë rrugore) dhe në sasi 204 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 263,301,717 lekë (100 % ndaj planit vjetor ( Grupi i produktit Sinjalistikë rrugore ) ose (100 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge) dhe në sasi janë realizuar 204 km ose 100 % kundrejt planit të këtij tipi rruge.

Përfshihen objektet:

- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore ne akset e Rajonit Verior, Loti 1;
- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore ne akset e Rajonit Qendror, Loti 2;

-Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Jugor, Loti 3;

-Ndërtim nënkalmi hekurudhor Hd=10 m në unazën Librazhd.

### **Shpronësime dhe Vendime gjyqësore, garanci objekti, leje mjedisore dhe ura**

	PLANIFIKUAR	REALIZUAR
- Vendime gjyqësore	350,000,000 lekë	350,000,000 lekë ose 100 %
- Shpronësime	300,000,000 lekë	300,000,000 lekë ose 100 %
- Blerje pajisje kompjuterike	17,562,820 lekë	17,522,440 lekë ose 100 %
-Blerje pajisjesh për akreditimin e Laboratorit të ARRSH	5,535,000 lekë	5,535,000 lekë ose 100 %
-Implementi i sistemit të menaxhimit të trafikut dhe instalimi i sensorëve peshë për aks	25,000,000 lekë	24,972,000 leke ose 100%
- Sistemi i menaxhimit të kontratave, inspektimi dhe raportimi	6,000,000 lekë	6,000,000 lekë ose 100 %

### **TVSH dhe Kosto Lokale**

	PLANIFIKUAR	REALIZUAR
-Kosto Lokale	983,027,362 lekë	976,640,795 lekë ose 99 %
-TVSH	1,835,400,857 lekë	1,781,090,082 lekë ose 97 %

### **FINANCIMI I HUAJ**

Buxheti për Investimet me Financim të huaj në vitin 2018 është miratuar në vlerën prej 6,338,100,000 lekë. Gjatë këtij viti këto investime janë financuar në vlerën prej 6,309,100,000 lekë ose në masën 99.5%

Në sasi në zërin ndërtim rrugësh Kategorija B , C edhe Kategoritë të ndryshme (Mirëmbajtja) janë planifikuar 2,058 km dhe janë realizuar 2,058 km.

Realizimi i produkteve dhe shpenzimeve :

#### **Ndërtim Rruge Tip B**

Për tipin e rrugës B janë planifikuar fonde në vlerën 3,278,320,357 lekë dhe në sasi 89 km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës B për 12 Mujorin është 3,278,320,357 lekë ose 100 % e planit. Në sasi janë realizuar 89 km të këtij tipi rruge.

#### **Ndërtim Rruge Tip C**

Për tipin e rrugës C janë planifikuar fonde në vlerën 205,217,000 lekë dhe në sasi 12 km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës C është 205,217,000 lekë ose 100 % e planit. Në sasi janë realizuar 12 km të këtij tipi rruge.

#### **Ndërtim Rruge Tip Kategoritë të Ndryshme**

Për tipin e rrugës Kategoritë të Ndryshme janë planifikuar fonde në vlerën 2,825,562,667 lekë dhe në sasi 1,957 km. Realizimi i shpenzimeve është 2,825,562,667 lekë ose 100 % e planit. Në sasi janë realizuar 1,957 km të këtyre kontratave.

Në këtë program përfshihen edhe Shpenzimet e investimeve për Institutin e Transportit.

Për vitin 2018 për këtë institucion u planifikuan 1,000,000 lekë nga të cilat u realizuan 962,000 lekë ose 96.2%. Me këto shpenzime është realizuar mbulimi i Kosto Lokale për projektet IPA planifikuar në vlerën 750,000 lekë dhe realizuar në vlerën 739,000 lekë dhe TVSH për projektet Ipa, Med planifikuar në vlerën 250,000 lekë dhe realizuar në vlerën në vlerën 223,000 lekë.

### **3. TRANSPORTI DETAR**

Për këtë program buxheti në total për vitin 2018 është 163,1 milion lekë dhe është realizuar 149,3 milion lekë ose 91,5 % kundrejt planit, nga të cilat :

- Buxheti i shpenzimeve korrente për vitin 2018, është 103,3 milion lekë dhe realizim financiar është 91,1 milion lekë ose 88,2%.
- Buxheti i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm për vitin 2018, është 59,8 milion lekë dhe realizimi financiar 58,1 milion lekë, ose 97 % .

Me Aktin Normativ nr. 1, datë 26.07.2018, është miratuar buxheti shtesë për detyrimet e prapambetura me fatura të prera për TVSH-në, për projektin "TVSh dhe taksë doganore për projektin e kalatës së në Portin e Shëngjinit" ne vleren 1.6 milion leke për projektin "TVSh dhe taksë doganore për projektin e rehabilitimit të kalatës në Portin e Vlorës" në vlerën 19.2 milion lekë, cili është realizuar në vleren 19,1 milion lekë, duke bërë të mundur kryerjen e pagesave të TVSH për faturat e prapambetura nga viti 2018.

Me Aktin Normativ nr.2, datë 19.12.2018, në zërin e financimit të huaj, është miratuar fondi 220 milion lekë, për projektin e Kooperacionit Italin "Ndërtimi i Fazës së I , II dhe pjesërisht i III" të Portit të Vlorës, për të cilën realizimi financiar për vitin 2018, ka qënë 9,3 milion lekë.

Plani i buxhetit për vitin 2018, sipas produkteve :

1. "Administrata e Drejtorisë së Përgjithshme Detare" planifikimi i fondeve buxhetore për shpenzimet per paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative, është në vlerën 103,3 milion lekë dhe realizimi financiar është 91,1 milion lekë ose 88 % kundrejt planit.
2. "Konservimi i Ndërmarrjes së Kontroll Shfrytëzimit të Mjeteve Ujore" (pagat e punonjësve për ndërmarrjen) është planifikuar fondi 3,4 milion lekë dhe realizimi financiar është në vlerën 3,4 milion lekë ose 100 % ndaj planit.
3. Projekti "Ndërtim i sistemit të LRIT", zbatohet nga Drejtorja e Përgjithshme Detare, për të cilin është lidhur kontrata në vlerën 76,5 milion lekë nga Agjencia e Teknologjisë së Informacionit. Buxheti për vitin 2018 është 24,5 milion lekë dhe realizimi financiar 24,5 milion lekë ose 100 % e planit e realizuar.
4. Projekti "Ndërtim i godinës së Kapitenerisë Shëngjin", me buxhet prej 11 milion lekë, realizim financiar në shumën 10,9 milion lekë ose 99 % e realizuar. Investimi ka përfunduar plotësisht.

### **4. TRANSPORTI HEKURUDHOR**



Programi “Transporti Hekurudhor ” ka për qëllim Integrimin e Sistemit Hekurudhor Shqiptar me atë Rajonal dhe Evropian nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave zhvilluese në fushën e infrastrukturës dhe mjeteve të transportit hekurudhor

Për këtë program buxheti në total për vitin 2018 është 1.053.891 mijë lekë dhe është realizuar 460.722 mijë lekë ose 44 % kundrejt planit, nga të cilat :

- Buxheti i shpenzimeve korrente për vitin 2018, është 423.891 mijë lekë dhe realizim financiar është 413.862 mijë lekë ose 98%.
- Buxheti i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm për vitin 2018, është 50.000 mijë lekë dhe realizimi financiar 46.860 mijë lekë, ose 94 % .

Financimi Huaj për projektin “Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës - Termali i pasagjerëve Tiranë dhe ndërtimi i linjës hekurudhore Tiranë–Rinas” (50% grant dhe 50% hua), ishte parashikuar 700 milion lekë dhe me Aktin Normativ nr. 1, datë 26.07.2018 u pakësua në vlerën 580 milion lekë. Ky financim nuk u realizua për shkak të mos përfundimit të tenderit të zbatimit të projektit, i zhvilluar nga BERZH, si tender ndërkombëtar.

Drejtimet e ku janë fokusuar politikat zbatuese me mbështetje buxhetore janë si më poshtë:

1. Reformimi i Sistemit Hekurudhor Shqiptar nëpërmjet hartimit të 6 akteve nënligjore dhe fillimit të procesit të ndarjes administrative të sistemit hekurudhor. Në këtë drejtim është akorduar subvencioni prej 400 000 milion lekë.
2. Transformimi i Infrastrukturës Hekurudhore dhe i mjeteve lëvizëse në sistemin hekurudhor nëpërmjet studimeve dhe projekteve për rikonstrukcion të linjave të vjetra dhe ndërtimin e linjave të reja.
3. Ruajtja e statuquo e sistemit hekurudhor nëpërmjet mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe mjeteve hekurudhore si dhe kontrollit të sigurisë në lëvizje.

## **5. TRANSPORTI AJROR**

Në këtë program janë përfshirë shpenzime për funksionimin e administratës së Organit Kombëtar të Incidenteve/Aksidenteve Ajrore, në të cilat përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe mallra dhe shërbime, për mbarëvajtjen e funksionimit të kësaj strukture.

Në këtë program buxhetor janë përfshirë investime të nevojshme për Organin Kombëtar të Investigimit të Incidenteve/Aksidenteve Ajrore. Procedurat dhe rolin e autoritetit kontraktor në lidhje me zërat e investimeve kryhen nga ky Organ që funksionon si një institucion vartësie.

Në këtë program buxhetor për vitin 2018 janë përfshirë Shërbim Konsulence për asistencën e Komisionit të Negocimit midis Shtetit Shqiptar dhe Kompanisë CENGIZ construction & Kalyon & Kolin për ndërtimin e Aeroportit të Vlorës.

Objektivat dhe produktet të cilat janë arritur gjatë kësaj periudhe, përgjithësisht janë të lidhur me:

- zhvillimin dhe ndërtimin e infrastrukturave të reja aeroportuale, me qëllim krijimin e një tregu konkurrues me shërbime ajrore të liberalizuar
- rritjen e standarteve dhe performancës së Organit Kombëtar të incidenteve/Aksidenteve ajrore nëpërmjet investimeve për forcimin e kapaciteteve,

Për vitin 2018 janë planifikuar investime për administratën e OKIIA, në buxhetin e rishikuar, në vlerën 5 milion lekë, që lidhen me pajisje për inspektorët e investigimeve ajrore si dhe të ambienteve të stafit, respektivisht në vlerat si më poshtë:

	000/lekë
Rikonstruksion, riparim dhe sistemim i ambienteve te OKIAA	1,900
Paisje plotesuese per canten e investigatorit	800
Blerje paisje per laboratorin e zerit	700
Blerje paisje investiguese	800
Blerje pajisje elektronike OKIIA (fond i ngrire)	500
Hartimi i projektit për ndërtimin e Hangarit	300

Këto investime të planifikuara për vitin 2018, për periudhën 12 mujore janë realizuar në masën 42 %. Ky realizim ka ardhur për shkak të mos kryerjes së procedurave të prokurimit nga ana e OKIIA.

## 6. FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIME

Për këtë program, Investimet me financim të brendshëm në buxhetin fillestar ishin planifikuar 3.686.000 mijë lekë dhe me buxhetin e rishikuar sipas Aktit Normativ nr.1 dhe nr.2, vlera e tyre arriti ne 3.448.287 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 3.345.117 mije lekë ose 97 % e planit.

Investimet me financim të huaj të planifikuara në vlerën 5.251.219 mije lekë janë realizuar në masën 3.734.721 mije lekë ose 71%.

### Realizimi sipas Produkteve për objektet me financim nga Buxheti Shtetit:

Për rezultatin A/I: *Linjë e re ujësjellësi për furnizimin me ujë*, investimet buxhetore në planin e vitit 2018, janë planifikuar në vlerën 1,946,105 mijë lekë dhe në përfundim të periudhës raportuese është realizuar financimi në vlerën 1,862,732 mijë lekë ose rreth 95% e planit të akorduar.

Për rezultatin A/II: *Rrjet kanalizimesh të ujrave të zeza i shtruar*, investimet buxhetore në planin e vitit 2018 janë planifikuar në vlerën 362,214 mijë lekë dhe në përfundim të periudhës raportuese është realizuar financimi në vlerën 360,013 mijë lekë, ose 99 % e planit të akorduar.

Për rezultatin A/III: *Impiant i trajtimit të ujrave të zeza*, investimet buxhetore në planin e vitit 2018, janë planifikuar në vlerën 743,652 mijë lekë dhe në përfundim të periudhës raportuese është realizuar financimi 743,652 mijë lekë, ose 100% e planit të akorduar.

Për rezultatin A/IV: *Diga e HEC Banjës i trajtuar*, investimet buxhetore në planin e vitit 2018, janë planifikuar në vlerën 4,300 mijë lekë dhe në përfundim të periudhës raportuese është realizuar financimi 3,572 mijë lekë, ose 96% e planit të akorduar.

Për rezultatin A/V: *Leje infrastrukturore*, investimet buxhetore në planin e vitit 2018, janë planifikuar në vlerën 1,500 mijë lekë në përfundim të periudhës raportuese është realizuar financimi 1,351 mijë lekë, ose 90% e planit të akorduar.

Për rezultatin A/VI: *Shpronësime*, nuk janë planifikuar investime buxhetore për vitin 2018.

Për rezultatin A/VII: *Supervizion punimesh*, investimet buxhetore në planin e vitit 2018, janë planifikuar në vlerën 21,986 mijë lekë dhe realizimi i këtyre fondeve për periudhën raportuese është në vlerën 20,706 mijë lekë ose 94% e planit të akorduar.

Për rezultatin A/VIII: *Studim dhe Oponence*, investimet buxhetore në planin e vitit 2018, janë planifikuar në vlerën 27,068 mijë lekë dhe realizimi i këtyre fondeve për periudhën raportuese është në vlerën 26,837 mijë lekë ose 99% e planit të akorduar.

#### Realizimi sipas produkteve për objektet me Financim të Huaj:

Për rezultatin B/I: *Linjë e re ujësjellësi për furnizimin me ujë*, investimet me Financim të Huaj për vitin 2018 janë planifikuar 2,249,278 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 2,245,436 mijë lekë ose 99 % e fondeve të akorduara.

Për rezultatin B/II: *Lidhje të reja të furnizimit me ujë*, nuk janë planifikuar investime me Financim të Huaj për vitin 2018.

Për rezultatin B/III: *Rrjet kanalizimesh të ujrave të zeza i shtruar*, Investimet me Financim të Huaj janë planifikuar 130,252 mijë lekë nga të cilat janë realizura 102,794 mijë lekë ose 79% e fondeve të akorduara.

Për rezultatin B/IV: *Ndërtim Impianti i Trajtimit të Ujrave të Zeza*, investimet me Financim të Huaj për vitin 2018, janë planifikuar 1,481,097 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 1,380,575 mijë lekë ose 93% e fondeve të akorduara.

Për rezultatin B/VII: *Konsulencë*, investimet me Financim të Huaj për vitin 2018, janë planifikuar 1,732,054 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 332,170 mijë lekë ose 19% e fondeve të akorduara.

Për rezultatin *Objekte të ujësjellës kanalizimeve*, fondet buxhetore :

për studime, projektim dhe oponencë teknike (art.230) për vitin 2018 janë planifikuar 27,068 mijë lekë dhe u realizuan 26,837 mijë lekë, ose 99% të planit të akorduar.

Për investime me financim të brendshëm, TVSH + KL, për vitin 2018 janë planifikuar 3,106,825 mijë lekë dhe u realizuan 3,018,863 mijë lekë ose 97% të planit të akorduar.  
TVSH + KL për vitin 2018 janë planifikuar 341,461 mijë lekë dhe u realizuan 326,253 mijë lekë ose 95% të planit të akorduar.

Për investime me financim të huaj për vitin 2018 janë planifikuar 5,251,219 mijë lekë dhe janë financuar 3,734,721 mijë lekë ose 71% të planit të akorduar.

Shpenzime për paga, plani vjetor është në vlerën 40,500 mijë lekë ndërsa realizimi për 2018 është në vlerën 33,180 mijë lekë ose 82% të planit të akorduar.

Shpenzime për sigurime shoqërore, plani vjetor është në vlerën 8,500 mijë lekë ndërsa realizimi faktik është në vlerën 5,199 mijë lekë ose 61 % të planit të akorduar.

Për mallra dhe shërbime të tjera plani vjetor është në vlerën 13,780 mijë lekë ndërsa realizimi faktik është në vlerën 5,110 mijë lekë ose 37 % të planit të akorduar.

Për subvencione për ndërmarrjet/sha.ujësjellës kanalizime për vitin 2018 janë planifikuar 1,000,000 mijë lekë dhe shpërndarja e fondeve për subvencion për ndërmarrjet SH.A Ujësjellës Kanalizime është 1,000,000 mijë lekë ose 100% të planit të akorduar.

Për shpenzime transporti, plani vjetor është në vlerën 210 mijë lekë ndërsa realizimi faktik është në vlerën 140 mijë lekë ose 67% të planit të akorduar.

## **7. MBETJET URBANE**

Në buxhetin e vitit 2018 për këtë program buxhetor janë planifikuar dhe janë realizuar:

1. Për projektin “Administrimi i mbetjeve të ngurta në Juglindje të Shqipërisë, Faza e dytë”, ishte planifikuar financim i huaj me vlerë 50,000,000 lekë dhe mbështetja buxhetore me TVSH 10,000,000 lekë. Gjatë vitit me ndryshimet në buxhet u pakësua financimi i huaj mirëpo nga monitorimi i produktit për vitin 2018 rezulton se janë disbursuar nga financimi i huaj 59,183,000 lekë dhe nga financimi i brendshëm janë disbursuar 5,214,113 lekë. Problematikë gjatë zbatimit të projektit ka qenë kundërshtimi i ndërtimit të stacionit të transferimit të mbetjeve në Pogradec nga bonorët e zonës. Ky projekt ishte parashikuar të përfundonte brenda vitit 2018 por është shtyrë me marrëveshje të nënshkruar me KfW dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
2. Për projektin “Venddepozitimi i Bushatit i ndërtuar (faza II)”, ishte planifikuar në vlerën 50,000,000 lekë. Gjatë vitit me ndryshimet në buxhet u rishikuan fondet për këtë projekt duke arritur në vlerën 126,005,000 lekë dhe realizimi në vlerën 126,005,000 lekë ose 100%. Zbatimi i kontratës ndiqet nga Bashkia Vau i Dejës.
3. Për projektin “Sistemi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Qarkun e Beratit”, ishte planifikuar financim i huaj me vlerë 50.000.000 lekë dhe 10,000,000 lekë TVSH. Me ndryshimet në buxhet u parashikuan 2,000,000 lekë TVSH, e cila nuk është realizuar për arsye të mos likuidimit nga Bashkia Berat të faturave të paraqitura nga konsulenti.
4. Financimi i produktit për “Sistemin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Qarkun e Vlorës”, ishte planifikuar financim i huaj me vlerë 400.000.000 lekë, dhe është realizuar 35,721,000 lekë. Ishte planifikuar financim i brendshëm 70,000,000 lekë TVSH dhe 10.000.000 lekë Kosto Lokale. Me ndryshimet në buxhet u parashikuan 9,995,318 lekë TVSH dhe u realizuan 7,170,160 lekë ose 72%, ndërsa kosto lokale nuk është realizuar pasi nuk ka patur nevojë për financimin e koston lokale.
5. Për projektin “Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Fier, (Inceneratori i Fierit)”, u parashikuan 752,772,000 lekë dhe u realizuan 752,770,224 lekë ose 100%. Disbursimet vazhdojnë sipas kontratës.
6. Për projektin “Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Elbasan (Inceneratori i Elbasanit)”, u parashikuan 661,500,000 lekë dhe u realizuan 601,430,371 lekë ose 91%. Disbursimet vazhdojnë sipas kontratës.

7. Për projektin “Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Tiranë (Inceneratori i Tiranës)”, u paarrshikuan 661,500,000 lekë dhe u realizuan 661,500,000 lekë ose 100%. Disbursimet vazhdojnë sipas kontratës dhe zbatohet nga Bashkia Tiranë.

## 8. MBËSHTETJE PËR ENERGINË

Programi konsiston në krijimin e kushteve dhe mundësive për zhvillimin e politikave dhe strategjive për një ecuri të qëndrueshëm dhe të sigurt të sektorit të energjisë, në zbatim të programit dhe prioritetëve të Qeverisë. Kjo politikë do të përqendrohet në realizimin e detyrave në zbatim të Traktatit për Krijimin e Komunitetit të Energjisë veçanërisht lidhur me ristrukturimin e tregut të energjisë duke bërë plotësimin e kuadrit ligjor dhe institucional në sektorin energjetik në përputhje me *acquis communautaire*; garantimin e një furnizimi të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të ekonomisë me burime energjetike, krijimin e kushteve të përshtatshme për përdorimin e energjive të rinovueshme, rritjen e efikasitetit të energjisë, nxitjen e zhvillimit të tregut të gazit natyror; mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e efikasitetit të burimeve natyrore tokësore dhe nëntokësore.

Mbështetja e politikës dhe prioritetëve të Qeverisë për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë nëpërmjet garantimit dhe furnizimit me burime të sigurta energjetike me kosto minimale. Pjesë e rëndësishme është edhe ruajtja e mjedisit nga efektet negative për shkak të zhvillimit të sektorit energjetik, diversifikimi i furnizimit me burime energjetike dhe integrimi në rrjetet energjetike rajonale dhe Europiane, duke nxitur investimet në këtë sektor. Nxitja dhe përdorimi i burimeve të rinovueshme si faktor për rritjen e sigurisë së furnizimit. Në terma konkretë ky program synon që të arrihet furnizimi i pandërprerë i konsumatorit me energji elektrike. Në vitin 2020 do të rritet përdorimi i energjisë së rinovuar me 38% kundrejt vitit 2009. Në vitin 2020 do të rritet efikasiteti i energjisë me 6.5% referuar vitit 2009.

Për vitin 2018, *objektivat* e këtij programi buxhetor janë:

- Komisionimi, marja në dorezim dhe oponenca e HEC-ve të vogla, si dhe hartimi i bilancit energjetik bazuar në përpunimin e informacionit sipas standarteve dhe rregulloreve të statistikës së energjisë të BE-së;
- Studimi për hartimin e rregullores për verifikimin e kriterëve të qëndrueshmërisë për biokarburantet, si dhe rishikimi i kushteve dhe normave teknike në aktivitetet dhe infrastrukturën e furnizimit me burime energjetike me bazë hidrokarbure;
- Auditimi dhe vendosja e skemës detyruese për efikasitetin e energjisë në 5-8 konsumatorët e mëdhenj publikë sipas ligjit 124/2015 për EE dhe Funksionimi i Agjencisë për Efikasitetin e Energjisë sipas ligjit 124/2015;
- Krijimi i kushteve për ndertimin e një infrastrukture ligjore të sigurtë për energjitë bërthamore.

Ky program buxhetor, përgjithësisht përfshin fondet buxhetore në mbështetje të politikave për fushën e energjisë, si atë elektroenergjetike, energjisë së rinovueshme dhe hidrokarburet për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Referuar të dhënave mbi shpenzimet faktike për periudhën Janar – Dhjetor 2018, rezultojnë se për vitin 2018 shpenzimet në total për këtë program janë realizuar në masën 96%. Nëpërmjet këtij programi financohen institucionet si AKBN, AKOB si dhe Agjencia e Efikasitetit të Energjisë.

Duke qenë se sektori energjetik është konsideruar si një sektor i një rëndësie të vecantë, puna është përqëndruar në përgatitjen e politikave në koherencë dhe cilësi, kryerjen në kohë të studimeve dhe opioncave të nevojshme në mbështetje të politikbërjes si dhe krijimit të kushteve të favorshme me synim orjentimin e profesionistëve dhe bizneseve drejt zbatimit të politikave për eficiencën e energjisë në Shqipëri. Kjo gjë vërehet dhe nga niveli i kënaqshëm i realizimit të shpenzimeve si në vlerë ashtu dhe referuar faktit.

Realizimi i buxhetit në nivel programi sic është theksuar dhe më sipër është i kënaqshëm afërsisht në masën 96 %, dhe kjo gjë vërehet në pjesën më të madhe të produkteve. Konkludojmë se, për realizimin e objektivave buxhetore të programit janë planifikuar 18 produkte, nga të cilat, produkti O është paraqitur me nivel realizimi zero (0) % dhe produktet P dhe R janë paraqitur me nivel të ulët realizimi, konkretisht 55% dhe 59%.

Në përgjithësi 15 produktet e tjera në këtë program paraqiten me një nivel të shumë të kënaqshëm realizimi që varion nga 94% deri në 100% të planit vjetor të rishikuar.

## 9. MBËSHTETJE PËR BURIMET NATYRORE

Programi “Mbështetje për Burimet Natyrore” ka për qëllim nxitjen e rritjes së sektorit përmes promovimit dhe inkurajimit të zbulimit të burimeve të reja potenciale mineralmbajtëse, përmes kompanive vendase e të huaja, të vogla dhe të mesme.

Nxitja dhe inkurajimi i ndërtimit të objekteve të përpunimit të mineraleve. Realizimi në vazhdimësi i funksioneve të mbikëqyrjes së shfrytëzimit racional e efektiv të pasurive minerale, monitorimit mineralar dhe të fenomeneve të postshfrytëzimit, rritja e kontrollit për rehabilitimin mineralar.

Përmiresimi e transparencës së biznesit në industrinë nxjerrëse, në mënyrë që të ardhurat nga ky biznes të kontribuojnë më shumë në zhvillimin e vendit. Fondet buxhetore në programin “Mbështetje për Burimet Natyrore”, përgjithësisht janë fonde buxhetore të nevojshme në mbështetje të politikave lidhur me fushën e menaxhimit të burimeve natyrore që synojnë jo vetëm zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit mineralar por dhe në rritjen e transparencës në shfrytëzimin racional të burimeve natyrore.

Referuar të dhënave mbi shpenzimet faktike, rezulton se për periudhën vitin 2018, shpenzimet në total janë realizuar në masën 96%. Në nivel programi realizimi i shpenzimeve korrente për vitin 2018 është 95% dhe i shpenzimeve kapitale është 97 %.

	Plani Vjetor rishikuar	Fakti	% e realizimit
Shpenzime korrente	155.395	146.864	95%
Financim i brendshëm	218.296	212.382	97%
<b>TOTALI</b>	<b>373.691</b>	<b>359.246</b>	<b>96%</b>

### *Projektet me Financim i Brendshëm*

Projektet me financim të brendshëm kryesisht janë projekte studimore në fushën minerare, të monitorimit të subjekteve minerare të licensuar në fushën e shfrytëzimit mineralar, studimeve gjeologjike, gjeofizike, hidrologjike etj, kontrollit dhe verifikimit të mënyrës dhe formës së shfrytëzimit të rezervave minerare, verifikimit të zbatimit të projekteve të hapjes dhe shfrytëzimit për objektet minerare etj. Në përgjithësi këto projekte implementohet nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Albaker, Albkrom dhe Albminierat.

Buxheti i vitit 2018, për investimet me financim të brendshëm, për programin ‘‘Mbështetje për burimet natyrore’’, ishte parashikuar në shumën prej 393,7 milion lekë. Me Aktin normativ nr. 1, datë 26.07.2018 ky buxhet u pakësua me 82 milion lekë dhe me Aktin normativ nr. 2, datë 19.12.2018, buxhet u pakësua me 102,4 milion lekë.

Sipas qëllimeve të detajuara janë :

**Qëllimi 1.** Shfrytëzimi me efikasitet i burimeve natyrore nga shoqëritë e licensuara për këtë veprimtari nëpërmjet zbatimit të kushteve tekniko profesionale dhe mjedisore sipas standarteve europiane.

Objektivat e këtij qëllimi realizohen nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, nëpërmjet 6 projekteve, për të cilët plani i buxhetit është 36 milion lekë dhe realizimi financiar 33,4 milion lekë si më poshtë:

Nr.	Emertimi i projektit	Buxheti për vitin 2018	Shpenzimet faktike viti 2018	Realizimi në % për vitin 2018
1	Dixhitalizimi i te dhenave te industrise minerare	2,000,000	0	0%
2	Raport mbi monitorimin e objekteve minerare	19,000,000	19,000,000	100%
3	Planet minerare vjetore	3,000,000	3,000,000	100%
4	Raport vjetor mjedisor	4,000,000	4,000,000	100%
5	Objekte minerare te monitoruara	8,000,000	8,000,000	100%
6	Laborator i akredituar	2,000,000	1,400,000	70%
	<b>Totali</b>	<b>36,000,000</b>	<b>33,400,000</b>	<b>93%</b>

**Qëllimi 2.** Promovimi i burimeve hidrologjike, minerare të pashfrytëzuara për nxitjen e shfrytëzimit të burimeve minerare. Parandalimi i rreziqeve gjeologo - mjedisore, hidrologjike, nëpërmjet monitorimit, kryerjes së 25 studimeve dhe analizave paraprake në mbështetje të pushtetit qendror dhe lokal, me qëllim zgjidhjen e problemeve që janë evidentuar në infrastrukturë.

Objektivat e këtij qëllimi realizohen nga veprimtaria e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar. Për këtë institucion në buxhetin e vitit 2018, janë planifikuar fonde për shpenzimet korrente (paga, sigurime shoqerore, shpenzime operative), ne shumen prej 155 milion leke dhe realizimi financiar eshte rreth 147 milion leke, ose 95% e planit e realizuar.

Projektet e investimeve me financim të brendshëm për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, u realizuna për :

- Blerje automjetesh teknologjike për nevoja të SHGJSH.
- Blerje paisje zyre.
- Blerje pajisje teknologjike

**Qëllimi 3.** Mbyllja dhe monitorimi i fenomeneve të post shfrytëzimit minierar.

Për vitin 2018 u parashikuan 62 milion lekë për mbylljen e 281 grykave të galerive të vjetra. Ky projekt është në proces dhe pritet të përfundojë brenda 6 mujorit të parë të vitit 2019.

**Qëllimi 4.** Rritja e cilësisë në mirëqeverisjen e industrisë nxjerrëse, nëpërmjet rritjes së transparencës në industri.

Ky qëllim realizohet nëpërmjet Sekretariatit për Nismën e Transparencës në Industrinë Nxjerrëse, për të cilin fondi i planifikuar është ne vlerën 12.5 mlion lekë dhe realizimi faktik në vlerën 10.9 milion lekë ose 88 %.

## 10. MBËSHËTETJE PËR INDUSTRIINË

Ky Program ka për qëllim zhvillimin e sektorit të industrisë jo ushqimore përmes promovimit dhe nxitjes së interesit të biznesit për mundësi zhvillimi të veprimtarive industriale, si dhe rritjen e shkallës së përpunimit në vend të burimeve natyrore, me synim rritjen e kontributit në GDP, eksport dhe punësim, për tërheqjen e investitorëve vendas e të huaj, likuidimin dhe mbylljen e ish ndërmarrjeve industriale, rehabilitimin e disa territoreve, si dhe objekteve ish industriale, rritjes së sigurisë të produkteve / pajisjeve / instalimeve dhe reduktimit të aksidenteve në punë dhe në miniera, rritjes së cilësisë së standardeve në treg të produkteve të naftës dhe gazit, minimizimin e rrezikut nga kimikatet e rrezikshme të papërdorshme gjendje në magazinat apo ambientet e ish ndërmarrjeve dhe subjekteve publike në varësi të MIE, administrimin e landfillleve me mbetje të rrezikshme të arsenikut ne ish Uzinën e Plehrave Azotike Fier ish PVC Vlorë.

### **Projektet me Financim i Brendshëm.**

Projektet me financim të brendshëm, kryesisht, janë projekte investimi në fushën e industrisë jo ushqimore, për konservimin, ruajtjen e ish ndërmarrjeve industriale, deri në privatizimin e plotë të tyre, rehabilitimin e disa territoreve, si dhe objekteve ish industriale për tërheqjen e investitorëve vendas e të huaj për shfrytëzimin e tyre për zona të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik dhe hartimin dhe promovimin e studimeve tekniko-ekonomike për zhvillimin dhe rritjen e prodhimit dhe përpunimit në vend të burimeve natyrore vendase, rritjen e kontrollit të standardeve në treg të naftës dhe gazit nëpërmjet monitorimit me aparatura laboratorike bashkëkohore, krijimin e kushteve të punës me pajisje profesionale për kryerjen e detyrave të inspektimit, shpëtimit dhe ndërhyrjeve emergjente në raste avarish dhe aksidentesh në punë dhe në miniera, administrimin e kimikateve të rrezikshme, gjendje në ish ndërmarrjet industriale dhe krijimin e kushteve sipas standardeve për grumbullimin dhe depozitimin e tyre në QGTK, Elbasan, administrimin dhe ruajtjen e landfillleve të mbetjeve të rrezikshme të arsenikut ne ish UPA Fier dhe zhivës ish PVC Vlore.

Buxheti i vitit 2018, për investimet me financim të brendshëm, për programin ‘Mbështetje për Industrinë’, është në shumën prej 146,1 milion lekë dhe realizimi financiar vjetor për vitin 2018, është në shumën prej 132,4 milion lekë, me një mosrealizim prej 13.7 milion ose realizimi në masen 91%.

Ndërsa buxheti i shpenzimeve korrente për vitin 2018, në këtë program është në vlerën 253,7 milion lekë dhe realizimi financiar për vitin 2018 është në vlerën 244,2 milion lekë, me një mosrealizim prej 9.5 milion, në përqindje realizimi prej 96 %.

### **Objektivi 1.**

Zhvillimi i strukturave dhe burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për monitorimin e sigurisë teknike të produkteve / pajisjeve / instalimeve, mbikëqyrjen e standardeve të tregut të produkteve të gazit dhe naftës, ndërhyrjet e shpëtimit në raste avarish në fushat e veprimtarisë së MIE.

Ky objektivi realizohet nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial.

Projekti i investimeve me financim të brendshëm për ISHTI është blerja e aparaturave laboratorike për treguesit cilësor të naftës dhe gazit, për të cilët plani i buxhetit është 15.172.000 lekë, realizimi 14.202.000 lekë ose 94% me një mosrealizim 970.000 lekë.



### **Objektivi 2.**

Rritja dhe përmirësimi i standardeve, kushteve të punës dhe të sigurisë së depozitimit dhe ruajtjes së kimikateve të rrezikshme në Qendrën Kombëtare e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve Elbasan (QKGTK).

Ky objektivi realizohet nga veprimtaria e QKGTK Elbasan. Projektet e investimeve me financim të brendshëm, nga 5 500.000 leke të planifikuara, janë realizuar 2 000.000 leke, ose në përqindje 36.3%, me një mosrealizim prej 3.500.000 leke për shkak të procedurës së prokurimit për Blerje e Vinçi pirun.

### **Objektivi 3.**

Përfundimi i procesit të likuidimit dhe mbylljes së ish ndërmarrjeve industriale në varësi të MIE. Rehabilitimi i territoreve të ish ndërmarrjeve për nxitjen e investitorëve dhe promovimin e tyre për përdorim, si zona të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.

Ky objektivi realizohet nga aparati i MIE për financimin e Ndërmarrjes Përpunimit të Çelikeve Elbasan, Kombinati Energjetik Elbasan, Uzina e Plehrave Azotike Fier, Prodhim Mobilje Sha Tiranë dhe Prodhim Kabllo Shkodër, duke u realizuar 100 % ose në vlerën 50.300.000 lekë.

Rehabilitimi i territoreve të ish ndërmarrjeve për nxitjen e investitorëve dhe promovimin e tyre për përdorim, si parqe industriale, realizohet nga aparati i MIE nëpërmjet projekteve të investimeve, si më poshtë:

*000 lekë*

Emërtimi i projektit	Buxheti për vitin 2018	Shpenzimet faktike vitit 2018	Realizimi në %
Azotiku - Kolaudim për rehabilitimin e uzinës	200	165	83%
Hartimi i projektit për rehabilitimin e Uzinës bakrit	960	960	100%-
Rehabilitimi i Uzinës së Rafinimit të Bakrit	57,340	57340	100%
Supervizim për Rehabilitimin e Uzinës së Rafinimit të Bakrit	1,600	780	49%
Kolaudim i punimeve për rehabilitimin e Uzinës së Bakrit Rubik	100	-	-

### **Objektivi 4.**

Hartimi i studimeve dhe promovimi tek biznesi i studimeve tekniko-ekonomike industrisë së nikel silikateve dhe kuarciteve, zhvillimit të QKGTK dhe hartimi i raporteve mjedisore, si dhe zhvillimi i disa ish territoreve industriale për ushtrimin e veprimtarive ekonomike, të cilat nga 2.000.000 lekë të planifikuar, janë realizuar 1.800.000 lekë, ose me realizim në përqindje prej 90%.

### **Objektivi 5.**

Zhvillimi i strukturave dhe burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për sigurimin e kushteve të domosdoshme për inspektimin dhe mbikëqyrjen e shëndetit, sigurisë në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore në miniera.

Ky objektiv realizohet nga veprimtaria e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera. Për këtë institucion në buxhetin e vitit 2018, janë planifikuar fonde për shpenzimet korente, në shumën prej 74.740.000 lekë dhe realizimi 72.940.997, në përqindje realizimi është 97.5% ose me një mosrealizim prej 1.799.003 leke. Investime janë planifikuar 6.000.000 leke, janë realizuar 3.969.840 lekë, ose 66%, me një mosrealizim prej 2.030.160 leke.

## **11. PLANIFIKIMI URBAN**

Politikat e këtij programi synojnë Planifikim dhe zhvillim të qëndrueshëm të territorit në çdo nivel dhe në integrim me çdo sektor; Rigjenerimin urban dhe krijimin e modeleve të reja të zhvillimit të territorit; Hartim politika dhe projekte në fushën e mbetjeve të ngurta urbane.

Qëllimi i politikës së këtij programi është Zhvillimi i qëndrueshëm dhe i balancuar i territorit, duke zbutur pabarazinë rajonale me 30%, deri në fund të vitit 2018, për garantimin e ekuilibrit midis interesave publikë dhe privatë, në zhvillimin e territorit; Kryerja e procesit mbi rikualifikimin urban të zonave përmes projektsh pilot, urbanizimi dhe integrimi; Hartimin e një masterplani për të gjithë territorin e vendit, sa i përket venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta, në bashkëpunim me partner të huaj, Hartimin e rregullave dhe standarteve të projektimit në disa fusha

Objektivat e politikës së programit janë Mbikëqyrja e procesit të hartimit dhe mbështetja teknike për hartimin e planeve të përgjithshme vendore në 16 bashki të vendit, koordinimi i procesit me grupet e interesit dhe publikun, duke i harmonizuar këto plane me PPK, PINS Durana dhe PINS Tiranë Durrës, Mbështetës në projekte, të cilat kanë fokus zhvillimin rajonal; Monitorimin dhe mbështetjen e projekteve që kanë ndikim në nivel rajonal dhe jo vetëm; Partnerë në analizimin e situatës dhe hartimin e Masterplanit të mbetjeve; Inicues të hartimit të rregullave teknike të projektimit, ndërtimit dhe operimit të veprave të prodhimit dhe furnizimit për ujë dhe pijshëm, mbledhjen dhe trajtimin e ujerave të zeza

Shpenzimet për programin “Planifikimi Urban”, në shpenzimet kapitale përfshihen projektet që ndjek Aparati i Ministrisë dhe në shpenzimet korrente përfshihen dy 2 institucione Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit dhe Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.

Shpenzimet korrente u planifikuan 97.750.000 lekë dhe u realizuan 88.257.000 lekë ose 90% ndërsa shpenzimet kapitale me financim të brendshëm u planifikuan 159.500.000 lekë dhe u realizuan 105.122.000 lekë ose 70%.

### **INVESTIMET ME FINANCIM TË HUAJ**

Investimet publike me financim të huaj, për vitin 2018, janë planifikuar në rreth 347 000 milionë lekë dhe deri në fund të vitit, janë realizuar në rreth 299 639 milionë lekë ose rreth 86.35%.

Sipas projekteve paraqiten si më poshtë:

Për projektin “Zhvillimi i integruar dhe i qëndrueshëm i zonës bregdetare, GIZ” janë parashikuar 82.440 milionë lekë dhe janë realizuar rreth 78.569 milionë lekë. Qeveria Gjermane nuk lëvront fonde direkt për sistemin buxhetor shqiptar, por shërbime në natyrë, për të cilat pagesat bëhen direkt nga llogaritë e donatorit.

Për projektin “Hartimi i master planit në fushën e mbetjeve, KfW” janë parashikuar 15.340 milionë lekë dhe deri në fund të vitit, janë realizuar në rreth 15.340 milionë lekë. Është nënshkruar marrëveshja nga KfW dhe Ministria e Financave, duke vijuar me hartimin e dokumentave sipas fazave të përcaktuara në marrëveshje.

Për projektin “Programi i Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë”, për vitin 2018, janë planifikuar në rreth 239.220 milionë lekë dhe deri në fund të vitit, janë realizuar 205.731 milionë lekë, nga shpenzimet me financim të huaj. Projekti ka përfunduar dhe do të vijohet për 2019 me FSHZH.

Për projektin "BRIGAD", për vitin 2018, janë planifikuar në rreth 10 milionë lekë, të cilat nuk janë realizuar.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Gentian Këri**